
PROJEKTI I MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

ALGRAFIKA sh.p.k.
Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k.
Si Shoqëri e Përthithur

- a. ALGRAFIKA SH.P.K.- Nr. 16 Prot. Tiranë, më 16/06/ 2021
- b. SHTYPSHKRONJA PROGRES SH.P.K. - Nr. 18 Prot. Tiranë, më 16/06/ 2021

PROJEKT BASHKIMI ME PËRTHITHJE TË SHTYPSHKRONJËS PROGRES SH.P.K NGA ALGRAFIKA SH.P.K

Ky projekt bashkimi me përthithje është hartuar nga:

- Administratori i shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k , Z. Ilir Dobi
- Administratori i shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k, Z. Ilir Dobi

Ky projekt për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të SHTYPSHKRONJËS PROGRES sh.p.k nga ALGRAFIKA sh.p.k është iniciuar nga ortaku i vetëm i shoqërive “DOBI MANAGEMENT” sh.p.k.

1. **ALGRAFIKA sh.p.k** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital të regjistruar 352,388,465.19 lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë 352,388,465.19 lekë, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Tirane Kashar, KASHAR, Autostrada TR-DR Km.8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Zona Kadastrale 2119, Nr. Pasurie 164/50, e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë Z. Ilir Dobi që për qëllim të kësaj marrëveshje, ALGRAFIKA sh.p.k do të quhet **“Shoqëria Përthithëse”**. Ortak i vetëm i shoqërisë është “DOBI MANAGEMENT” SH.P.K

dhe

2. **SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital themeltar të regjistruar 73,677,967 lekë, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Tirane Kashar, KASHAR, Autostrada TR-DR Km.8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Zona Kadastrale 2119, Nr. Pasurie 164/50, e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë Z. Ilir Dobi që për qëllim të kësaj marrëveshje SHTYPSHKRONJA PROGRES do të quhet **“Shoqëria e Përthithur”**. Ortak i vetëm i shoqërisë është “DOBI MANAGEMENT” sh.p.k.

DEKLARATA PARAPRAKE

- A. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Pjesa IX, Neni 215 deri tek Neni 225, me propozim të ortakut të vetëm të shoqërive hartohet kjo projekt marrëveshje për bashkimin me përthithje të SHTYPSHKRONJËS PROGRES sh.p.k nga ALGRAFIKA sh.p.k.
- B. Duke qënë se të dyja shoqëritë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe ALGRAFIKA sh.p.k zotërohen në masën 100% të kapitalit nga i njëjti Ortak që është “ DOBI MANAGEMENT” sh.p.k.

- C. Me qëllim përmirësimit e performancës ekonomike të Shoqërisë “ALGRAFIKA” sh.p.k në përputhje me objektivat e Shoqërisë, si edhe uljet e kostove administrative nëpërmjet përthithjes së SHTYPSHKRONJËS PROGRES sh.p.k nga ALGRAFIKA sh.p.k, e cila do të përmirësojë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve në teknologji. Gjithashtu bashkimi do të krijojë një shoqëri me një bazë më të gjerë asetesh e një vlerë neto biznesi më të lartë, e cila do të mundësojë një qëndrim dhe mbrojtje më të fortë ndaj risqeve të ndryshme gjatë operimit në treg. Me një portofol më të gjerë produktesh e klientësh, me një kontroll më të fortë të shpenzimeve administrative dhe për shkak të të gjithë elementëve të përmendur më sipër, shoqëria pas bashkimit do të gëzojë një kapacitet më të lartë se ai i dy shoqërive individualisht, në përfitim të shoqërisë së konsoliduar.
- D. ALGRAFIKA sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dëshirojnë të kryejnë një bashkim nëpërmjet të cilit ALGRAFIKA sh.p.k do të përthith shoqërinë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe shoqëria ALGRAFIKA sh.p.k do të vazhdojë aktivitetin, kurse SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k do të ç’regjistrohet pa kaluar në likuidim.
- E. Periudha nga data e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit (nënshkrimit të projekt marrëveshjes së bashkimit) deri në datën e regjistrimit të transaksionit të Bashkimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, do të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe ALGRAFIKA sh.p.k do të marrin një sërë masash e do të plotësojnë disa kushte më qëllim përmbushjen me sukses të Bashkimit me përthithje.
- F. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë projekt marrëveshje në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si mëposhtë:

Neni 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë projekt marrëveshje, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“**Shoqëri Përthithëse**” në projekt marrëveshje do të thotë shoqëria ALGRAFIKA sh.p.k.

“**Shoqëri e Përthithur**” në projekt marrëveshje do të thotë shoqëria SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k.

“**Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit**” do të thotë data e miratimit të marrëveshjes nga ortaku i vetëm i të dy shoqërive ALGRAFIKA sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 220, paragrafi 3 i Ligjit Tregëtar.

“Data e Bashkimit” ka kuptimin që i është dhënë në piken 1.4 që do të thotë data 01/01/2021.

“Periudha Kalimtare” do të thotë periudha kohore nga data e miratimit nga ortaku i vetëm i të dy shoqërive të Projektit të Bashkimit, deri në mbyllje gjatë së cilës shoqëritë ALGRAFIKA sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim përmbushjen e transaksionit të Bashkimit me Përthithje.

“Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse” do të bazohet në bilancin e konsoliduar të datës së Fundit Kontabël të të dy shoqërive, pra data 31.12.2020 përpara përthithjes.

“Marrëveshje” nënkupton këtë marrëveshje.

“Data e nënshkrimit” nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj projekt marrëveshje nga të dyja palet, ashtu siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj marrëveshje.

Neni 2

BASHKIMI, KËMBIMI I AKSIONEVE

- 2.1 Në bazë të kushteve të projekt marrëveshjes, ALGRAFIKA sh.p.k do të përthithë Shoqërinë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të marrëveshjes nga ortaku i vetëm i Shoqërive ALGRAFIKA sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Bashkimi me Përthithje bazohet në Pasqyrat Financiare të ALGRAFIKËS sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJËS PROGRES sh.p.k të datës 31.12.2020, e cila është edhe Data e Fundit Kontabël.
- 2.3 SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k do t’i transferojë Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivitetit të pasivitetit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Mbylljes.
- 2.4 Si rezultat i operacionit të bashkimit, Kapitali i Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k në Datën Efektive të Mbylljes do të rritet me shumën 73,677,967 lekë, që i përket shumës së Kapitalit të Shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k në datën e bashkimit. Mbas rritjes Kapitali i Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k bëhet 426,066,432.19 lekë dhe numri i kuotave nuk ndryshon, mbetet 1 kuotë, dhe zotues i saj është ortaku i vetëm i të dy shoqërive “DOBI MANAGEMENT” sh.p.k.
- 2.5 Data e Bashkimit është data 01.01.2021, që do të thotë që të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k, që nga data 01.01.2021 deri në Datën e regjistrimit përfundimtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), do të konsiderohen si të kryera nga ALGRAFIKA sh.p.k.
- 2.6 Bilanci i Hapjes së Shoqërisë Përthithëse në datën e bashkimit do të jetë bilanci i konsoliduar i të dy shoqërive para përthithjes, në datë 31.12.2020 (Data e Fundit Kontabël). Çdo ndryshim dhe korrigjim i

mundshëm i kryer midis Datës së Fundit Kontabël dhe datës së mbylljes do të reflektohet në Marrvëshjen Përfundimtare të Bashkimit.

- 2.7 Statuti i Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithëse.
- 2.8 Anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k në datën e mbylljes do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.
- 2.9 Administratori i shoqërisë Përthithëse do vazhdojë të jetë Z. Ilir Dobi, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Neni 3

EKSPERTËT

Me qëllim vlerësimin e kushteve të Projekt marrëveshjes së bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë Bashkimi me Përthithje, emërohet shoqëria MAZARS sh.p.k me Partnerë Angazhimi Znj. Irena HOXHA (Pulo), e bija e Jahjait, e dtl. 27 Prill 1963, banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, Audituese Ligjore, anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr.20, dt. 10/01/2000.

Audituesi ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim nëpërmjet të cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i Shoqërisë Përthithëse (shoqërisë përfituese të kontributeve) pas realizimit të procesit të Bashkimit me Përthithje me shoqërinë “SHTYPSHKRONJA PROGRES” sh.p.k (shoqëria kontribuese) do të përbëhet nga shuma e kapitaleve të secilës prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi, vlerë e cila do të përcaktohet me paraqitjen nga Audituesi Ligjor të raportit për modalitetet e bashkimit dhe vlerësimin e kapitaleve të dy shoqërive.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë proces Bashkim me Përthithje, garantojnë sipas ligjit se audituesit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllim kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme.

Neni 4
AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që shoqëria **SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k** t'ia transferojë shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k tërësinë e elementëve të aktivitetit e të pasivitetit gjëndje më datë 31.12. 2020 si më poshte:

SHTYPSHKRONJA PROGRES SH.P.K.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

AKTIVE	Shënime	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktivitet afatshkurtra			
Mjetet monetare		3,982,596	8,489,974
Llogari të arkëtueshme		10,061,653	7,398,197
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		12,742,041	21,066,367
Aktive të tjera afatshkurtra		29,858,343	32,075,476
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		5,505,251	11,138,508
Inventari		96,368,480	73,375,706
Totali i aktiveve afatshkurtra		<u>158,518,365</u>	<u>153,544,227</u>
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale		41,109,460	45,705,157
Totali i aktiveve afatgjata		<u>41,109,460</u>	<u>45,705,157</u>
Totali i aktiveve		<u>199,627,825</u>	<u>199,249,384</u>
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme		4,350,506	2,731,092
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		13,603,912	13,461,546
Detyrime tatimore		164,236	251,772
Detyrime të tjera		2,341,104	354,337
Totali i detyrimeve afatshkurtra		<u>20,459,759</u>	<u>16,798,747</u>
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Detyrimi tatimor i shtyrë		1,499,899	764,673
Të pagueshme ndaj ortakëve		130,918,893	114,547,714
Totali i detyrimeve afatgjata		<u>132,418,792</u>	<u>115,312,387</u>
Totali i detyrimeve		<u>152,878,551</u>	<u>132,111,134</u>

KAPITALI

Kapitali i Nënshkruar	73,677,967	84,356,832
Fitimet e pashpërndara	(17,218,582)	(23,020,401)
Fitimi i ushtrimit	(9,710,111)	5,801,819
Totali i kapitalit	46,749,274	67,138,250
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	199,627,825	199,249,384

Ndërkohë, të dhënat e Pasqyrës së Pozicionit Financiar të shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k më datë 31 Dhjetor 2020 që janë marrë si bazë për hartimin e projekt marrëveshjes së bashkimit janë si më poshtë:

ALGRAFIKA SH.P.K.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

	Shënime	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
AKTIVE			
Aktivët afatshkurtra			
Mjetet monetare		17,907,184	12,396,107
Llogari të arkëtueshme		205,649,721	184,444,077
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		7,826,021	11,844,706
Aktive të tjera afatshkurtra		6,582,835	20,907,483
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		50,878,975	63,047,393
Inventari		283,842,337	289,362,607
Aktiv tatimor i shtyrë		3,085,186	2,281,882
Totali i aktiveve afatshkurtra		575,772,260	584,284,255
Aktivët afatgjata			
Aktivët afatgjata materiale		358,726,277	370,032,200
Totali i aktiveve afatgjata		358,726,277	370,032,200
Totali i aktiveve		934,498,536	954,316,455
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme		4,944,044	8,248,536
Parapagimet e arkëtuara		35,462,514	33,715,344
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		30,308,198	43,380,940
Detyrime afatshkurtra të huave që mbartin interesa		87,418,767	146,945,294
Detyrime tatimore		1,638,237	823,779
Detyrime të tjera		23,867,210	941,473
Totali i detyrimeve afatshkurtra		183,638,969	234,055,366
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua që mbartin interesa		82,324,824	60,885,018
Hua nga palët e treta		81,080,091	-
Të pagueshme ndaj ortakëve		203,896,374	250,710,870
Totali i detyrimeve afatgjata		367,301,289	311,595,888

Totali i detyrimeve	550,940,258	545,651,254
KAPITALI		
Kapitali i Nënshkruar	352,388,465	390,912,889
Fitimi i ushtrimit	31,169,813	17,752,312
Totali i kapitalit	383,558,278	408,665,201
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	934,498,536	954,316,455

Mbas realizimit të operacionit të bashkimit të dhënat e Pasqyrësë Pozicionit Financiar të shoqërisë **ALGRAFIKA sh.p.k** më datë **01.01.2021** mbas bashkimit me përthithje paraqiten si më poshtë:

ALGRAFIKA SH.P.K.

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

Shënime	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
AKTIVE		
Aktivët afatshkurtra		
Mjetet monetare	21,889,781	20,886,081
Llogari të arkëtueshme	215,711,374	191,842,273
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	20,568,062	32,911,073
Aktive të tjera afatshkurtra	36,441,178	52,982,959
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	56,384,226	74,185,901
Inventari	380,210,817	362,738,313
Aktiv tatimor i shtyrë	3,085,186	2,281,882
Totali i aktiveve afatshkurtra	734,290,625	737,828,482
Aktivët afatgjatë		
Aktivët afatgjatë materiale	399,835,736	415,737,357
Totali i aktiveve afatgjatë	399,835,736	415,737,357
Totali i aktiveve	1,134,126,361	1,153,565,839
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme	9,294,550	10,979,628
Parapagimet e arkëtuara	35,462,514	33,715,344
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	43,912,110	56,842,486
Detyrime afatshkurtra të huave që mbartin interesa	87,418,767	146,945,294
Detyrime tatimore	1,802,473	1,075,551
Detyrime të tjera	26,208,314	1,295,810
Totali i detyrimeve afatshkurtra	204,098,727	250,854,113
DETYRIMET		
Detyrime afatgjatë		
Detyrimi tatimor i shtyrë	1,499,899	764,673
Hua që mbartin interesa	82,324,824	60,885,018
Hua nga palët e treta	81,080,091	-

Të pagueshme ndaj ortakeve	334,815,267	365,258,584
Totali i detyrimeve afatgjata	499,720,082	365,258,584
Totali i detyrimeve	703,818,809	677,762,388
KAPITALI		
Kapitali i Nënshkruar	426,066,432	475,269,721
Fitimet e pashpërndara	(17,218,582)	(23,020,401)
Fitimi i ushtrimit	21,459,703	23,554,131
Totali i kapitalit	430,307,553	475,803,451
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	1,134,126,362	1,153,565,839

Neni 5

MODALITETET

- 5.1 ALGRAFIKA sh.p.k do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të Shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k në datën Efektive të Bashkimit.
- 5.2 ALGRAFIKA sh.p.k në datën Efektive të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe liçensat e zotëruara nga SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k në këtë datë.
- 5.3 Punonjësit e shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës tek shoqëria ALGRAFIKA sh.p.k.

Neni 6

GARANCITË PËR KREDITORËT DHE MBROJTJA E TYRE

- 6.1 Palët në këtë procedurë Bashkimi me Përthithje të shoqërive të mësipërme, garantojnë kreditorët e shoqërive të përfshira në këtë bashkim, sidomos ata të Shoqërisë së Përthithur se megjithëse debitori fillestar humbet (pra, shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen shoqërisë përthithëse "ALGRAFIKA" sh.p.k.
- 6.2 Shoqëria përthithëse (ALGRAFIKA sh.p.k) merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur (SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k) në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti drejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithëse.
- 6.3 Gjithashtu, në vecanti shoqëria përthithëse (ALGRAFIKA sh.p.k) merr përsipër përmbushjen e detyrimeve dhe te gjitha efektet që rrjedhin edhe nga Kontrata e Huasë, datë 30.12.2019 me Huadhënës Z. Ervis Aga dhe Huamarrës SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k. Gjithashtu, ALGRAFIKA sh.p.k mbas mbylljes së procedurës së përthithjes, angazhohet që së bashku me Huadhënësin Z. Ervis Aga, të

amendojnë Kontraten e Huasë, datë 30.12.2019 me Huadhënës Z. Ervis Aga dhe Huamarrëse ALGRAFIKA Shpk., duke shtuar (përthithur) detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia juridike e Huasë që ishte në ngarkim të debitorit të përthithur SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k.

Neni 7

DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k nga data 01.01.2021 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilin do të ndodhi ç’regjistrimi pa likuidim i shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithëse ALGRAFIKA sh.p.k dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31.12. 2020, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dy shoqërive, ai i datës 31.12.2020.

Neni 8

DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë projekt, Bashkimi me Përthithje, janë hartuar duke u referuar datës 31.12.2020, si për shoqërinë përthithëse ashtu edhe për shoqërinë e përthithur.

Neni 9

RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që ALGRAFIKA sh.p.k dhe SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k zotërohen 100% nga i njëjti ortak, shoqëria “DOBI MANAGEMENT” sh.p.k, i gjithë kapitali i regjistruar i Shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k, do të rrisë kapitalin e shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k..

Si rezultat i operacionit të bashkimit, Kapitali i Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k në Datën Efektive të Mbylljes do të rritet me shumën 73,677,967 lekë, që i përket shumës së Kapitalit të Shoqërisë SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k në datën e bashkimit. Mbas rritjes;

- Kapitali i Shoqërisë ALGRAFIKA sh.p.k bëhet 426,066,432 lekë dhe numri i kuotave mbetet 1 kuotë.
- Zotërues i saj është ortaku i vetëm i te dy shoqërive “**DOBI MANAGEMENT” sh.p.k.**

Pavarësisht nga sa me sipër, i është kërkuar Audituesit Ligjor në Raportin e bashkimit të hartuar prej tij të përcaktojë raportin e këmbimit të kuotave të secilës shoqëri në raport me shoqërinë e bashkuar.

Neni 10**SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT**

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

Neni 11**TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA**

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Neni 12**PREMTIME DERI NË MBYLLJE**

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

- a) të ndërnarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar Marrëveshjen e Bashkimit, si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to;
- b) të ndërnarrin çdo veprim për depozitim të të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 13**MBYLLJA E OPERACIONIT**

10.1. Mbyllja e operacionit të bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë ALGRAFIKA sh.p. në adresën: Tiranë Kashar, KASHAR Autostrada TR-DR Km.8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Zona Kadastrale 2119, Nr. Pasurie 164/50.

10.2. Në mbyllje, ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:

- a) Të gjithë vendimet e ortakut të vetëm në lidhje me këtë operacion.

- b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm.
- c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse

Neni 14

DEKLARIMET DHE GARANCITE

Deklarimet dhe Garancitë e ALGRAFIKA sh.p.k:

- ALGRAFIKA sh.p.k dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- ALGRAFIKA sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrimje ose në proces likuidimi.

Deklarimet dhe Garancitë e SHTYPSHKRONJËS PROGRES sh.p.k:

- SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrimje ose në proces likuidimi.

Neni 15

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para Datës së Mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja palëve.

Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë me anë të njoftimit me shkrim të palës tjetër, para Datës së Mbylljes, nëse bashkimi nuk përfundon.

Neni 16

KONFIDENCIALITETI

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfuara si rezultat i nisjes dhe përmbyshjes së kësaj Marrëveshje, të cilat kanë lidhje me negociatat, për mbushjen dhe mbylljen e kësaj marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo marrëveshje.

Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore.
- b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar.
- c) Me miratimin parapark me shkrim të palës tjetër.

Neni 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo marrëveshje rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

TË PËRGJITHSHME

Kjo projekt marrëveshje bashkimi dhe raporti do të depozitohet sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, duke publikuar edhe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet _____ të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitim të të gjitha akteve për realizimin e kësaj procedure të bashkimit me përthithje.

Neni 19

TË NDRYSHME

- a) Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara apo dhe të lejuara nga kjo marrëveshje, do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresën si më poshtë vijon, derisa Palët të njoftojnë njëri-tjetrin për ndryshime të adresave të tyre.
- b)

Për ALGRAFIKA sh.p.k :

Tiranë Kashar, KASHAR Autostrada TR-DR
Km.8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Zona
Kadastrale 2119, Nr. Pasurie 164/50

Në vëmendje të: Z. Ilir Dobi

Për SHTYPSHKRONJA PROGRES sh.p.k:

Tiranë Kashar, KASHAR Autostrada TR-DR
Km.8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Zona
Kadastrale 2119, Nr Pasurie 164/50.

Në vëmendje të: Z. Ilir Dobi

- c) Ndryshime

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përveçse me shkrim dhe e nënshkruar nga palët.

Kjo marrëveshje u hartua sot më datë 16/06/21, në 6 kopje origjinale dhe u nënshkrua nga:

PALËT

Shoqëria
ALGRAFIKA sh.p.k
Përfaqësuar nga:

Z. Ilir Dobi

Z. Ilir Dobi
Administrator



Shoqëria
SHTYPSHKRONJA PROGRES
Përfaqësuar nga:

Z. Ilir Dobi

Z. Ilir Dobi
Administrator

